



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Borxhi publik në 2018 ulet 2.5%. Më shumë përgjegjshmëri e cilësi në menaxhim!

2017-11-10 12:26:00



Borxhi publik është elementi kryesor i financave publike rreth të cilit ankorohet i gjithë procesi i programimit të buxhetit vjetor dhe atij afatmesem.

Është tashmë e pranuar prej kohësh dhe gjerësisht, si nga shumica e palëve politike, ashtu edhe nga institucione të brendshme apo të huaja të specializuara në vlerësimet makroekonomike, se niveli aktual i borxhit publik për vendin tonë është relativisht i lartë dhe mbart risqe të larta për stabilitetin makroekonomik të vendit dhe mbarëvajtjen e ekonomisë.

E nisa me këtë paragraf, për të evituar një debat jo-profesional brenda nesh, se çfarë presupozon borxhi në nivelet që e kemi.

Në këtë frymë politika jonë fiskale si ankorë kryesore të saj, vijon të ketë në mënyrë të vendosur konsolidimin fiskal dhe uljen e borxhit publik në raport me PBB.

Në vitin 2016, këtë synim strategjik të politikës fiskale, pra domosdoshmërinë për konsolidim fiskal dhe uljen e raportit të borxhit publik, ne e fiksuar edhe në ligjin kryesor të menaxhimit të financave publike, pra në ligjin organik të buxhetit.

Tashmë është e sanksionuar edhe me ligj, e kam përsëritur vazhdimisht, që cdo qeveri jo vetëm që nuk mund të rrisë borxhin publik, por është e detyruar që në cdo raund të programimit të buxheteve vjetore apo atyre afatmesme, të targetojë për cdo vit një nivel më të ulët të borxhit publik se sa viti pararendës, dhe kjo duhet të vijojë të paktën deri atëherë kur niveli borxhit të zbrësë në 45% të PBB, nivel i cili vlerësohet gjerësisht si niveli më optimal për një ekonomi si e jona.

Këtu dua të theksoj që ishte një iniciativë e vetë qeverisë shqiptare që të vintë kushte mbi veten e vet dhe mbi cdo qeveri që do të drejtojë vendin në vitet që vijnë deri ditën që ne realizojmë targetin që unë i referohem si niveli 45% i PBB.

Dhe me nivel optimal të borxhit publik kam parasysh atë nivel që nga njëra anë lë hapësirën e arsyeshme për ta përdorur konceptin e borxhit si një instrument efikas për të përshpejtuar zhvillimin e vendit apo ekonomisë me një ritëm më të shpejtë se sa ai do të zhvillohej, nese nuk do e utilizeonte borxhin si instrument zhvillimi dhe kam dëgjuar disa debate përtej logjikës profesionale apo politike, nga persona që kanë thënë me bindje "le të rrisim borxhin".

Kam dëgjuar here pas here në retorikën tonë të përditshme pikëpamje të llojit "çfarë problemi ka nëse kemi borxh 70%, le ta cojmë atë 80% apo 90% e në këtë mënyrë të mund të kemi një rritje më të lartë ekonomike." dhe në mbështetje të kësaj pikëpamje sillen shembuj si Japonia që ka një borxh 200%, SHBA me 100%, e të tjerë të kësaj natyre. Padyshim që cdo person apo forcë politike ka të drejtën e vet të ketë këtë pikëpamje dhe unë e respektoj, por kjo qeveri dhe unë si Ministër Financash, jemi të gjykimit që këto pikëpamje lidhur me këtë nivel të borxhit dhe krahasimet me vendet etjera të cilat janë diametralisht të ndryshme në një sërë aspektesh kyce ekonomike me vendin tonë, gjykoj se janë pikëpamje krejt sipërfaqësore, të gabuara dhe patjetër që na cojnë

definitivisht dhe në debatin tonë publik dhe politik, në drejtimin e gabuar.

Vende si këto që përmenda më sipër kanë nivele borxhi afër apo mbi 100% të PBB, por në raport me të ardhurat sigurisht që janë në nivele ku mund të përballojnë kostot e tyre të borxhit dhe një ekonomi si e jona në mënyrë absolute, nuk mund të krahasohet me këto nivele.

Në këtë dua të përmend disa nga targetat kryesorë të politikës fiskale të materializuara në buxhetin e vitit 2018, por edhe në një perspektivë afatmesme:

1. Në vitin 2018, i cili është edhe viti i dytë buxhetor ku politika fiskale kryhet tashmë nën ombrellën e rregullave të rinj fiskal të inkuorporuar në LOB, ne targetojmë një reduktim të borxhit publik me rreth 2.5 pikë përqindje. Ekzaktësisht reduktimi i targetuar për 2018 është 2.8 pikë përqindje ndaj nivelit të pritur në fund të 2017, por një pjesë midis këtyre viteve (rreth 0.8% e PBB) është huamarrje tranzitore e cila cila merret në 2017 nga mbeshtetja buxhetore nga BB dhe do të përdoret në vitin 2018 në kuadër të optimizimit të cash-floë dhe menaxhimit të borxhit.

Për herë të parë kemi futur edhe në ligjin vjetor të buxhetit këtë koncept si paragraf më vete të një neni.

Reduktimi në këtë nivel jo vetëm që vlerësojmë se është trajektorja optimale që duhet të ndjekë borxhi publik, por gjithashtu shpresojmë që kjo të kthehet edhe në një normë apo standard për cdo qeveri në vijim sa i takon interpretimit praktik të rregullit fiskal që përmenda më sipër, pra të detyrimit ligjor tashmë të cdo qeverie për të targetuar një borxh në ulje në cdo vit buxhetor.

Ndërsa në afatin e mesëm ne synojmë të arrijmë të ulim borxhin rreth nivelit 60% në vitin 2021. Këtu dua të sjell në vëmendjen tuaj se edhe pse tashmë ne nuk jemi në një marrveshje programi me FMN, pra një marrveshje të kushtëzuar, por patjetër jemi në një marrveshje monitorimi, sërish ky target afatmesëm i politikës fiskale që ne kemi vendosur për nivelin e borxhit publik është i njëjtë me atë që rekomandon edhe FMN.

Ndërkohë është e kuptueshme që FMN gjykon se reduktimi duhet të jetë më i fortë në fillim të periudhës e cila do të kërkonte masa shtesë vecanërisht në taksa, ndërsa ne jemi të gjykimit se do ishte më optimale për ekonominë në tërësi, që reduktimi të bëhet pak sa më gradual gjatë viteve të para të mandatit me qëllim që t'i lihet hapësirë momentumit të mirë të krijuar të rritjes ekonomike dhe gjatë dy vitetve të dyta reduktimi të vinte i natyrshëm prej rritjes ekonomike pa patur nevojë për marrjen e masave shtrënguese.

Por gjithsesi e ritheksoj, sa i takon objektivit në afatmesëm ne po programojmë të njëjtën politikë fiskale me atë c'ka gjykon edhe FMN se do të ishte optimale për vendin tonë.

2. Niveli i deficiti të përgjithshëm që ne targetojmë në buxhetin e vitin 2018 është 2% e PBB, që është niveli më i ulët i targetuar ndonjëherë, njësoj sa ai i targetuar edhe për vitin aktual 2017.

3. Niveli i balancës primare patjetër që edhe këtë vit, ashtu si dhe vitin e kaluar, targetohet me suficit prej +0.6% të PBB nga +0.4% që pritet të rezultojë gjatë këtij viti. Pra edhe pse pa një program politikash me FMN, sërish ne targetojmë një balancë primare me suficit dhe në rritje nga një vit më parë, që në terma të tjera do të thotë "konsolidim i qartë fiskal".

Balanca primare pozitive presupozon, për qytetarët, se qeveria me operacionet e veta korrente nuk krijon borxh të ri, përkundrazi, kusen para për të paguar borxhin e trashëguar. E nëse balanca primare do të ishte negative siç ka qenë në gati 10 -15 vitet që kanë kaluar, presupozohet që ajo qeveri krijon borxh të ri. Pra, për të gjithë ata qytetarë që mund të na ndjekin, apo media që është e interesuar, kjo qeveri ka tre vite rresht që jo vetëm që nuk krijon borxh të ri, por kursen për të paguar borxhin e krijuar ndër vite e vite.

4. Një tjetër parametër shumë i rëndësishëm është balanca korrente, e cila tregon në terma makro, se në çfarë mënyrë përdoret borxhi, pra çfarë efijence ka përdorimi borxhit që merret nga qeveria gjatë një viti të caktuar. Tashmë e kemi deklaruar qartë se një nga prioritetet kryesore të kësaj qeverie të mishëruar në buxhetin e vitit që vjen, po natyrshëm gjatë gjithë këtij mandati, janë investimet publike.

Unë padyshim shikoj që arritja më e madhe e këtij buxheti dhe elementi më optimal i tij për ekonominë e vendit është që, ndërkohë që targetojmë një reduktim të nivelit të borxhit me 2 pikë % në

pragun kohorë të një viti, në të njëjtën kohë arrijmë të programojmë investime publike në nivelin prej mbi 5% të PBB. Ky buxhet targeton një balancë korente pozitive nga më të lartat historike prej 3.3 plus % të PBB. Kjo sigurisht që respekton katërcipërisht dhe rregullin tjetër fiskal të sanksionuar në Ligjin Organik të Buxhetit, të Raportit me Investime Publike me Huamarrje Vjetore, apo siç njihet ndryshe dhe si rregulli i artë fiskal.

Këtu më vonë, kur të fillojë natyrshëm debati, unë kam disa raporte për të 3 mandatet e fundit të qeverive, 2005-2009, 2009-2013, 2013-2017, se si është përdorur borxhi, se çfarë efektiviteti ka pasur. Janë shifra kokëfortë që flasin vetë. Në të njëjtën kohë do të ndaj me ju dhe me mediat ndër vite balancën korente, balancën primare që nga 2010 e këtej, për të parë se çfarë përgjegjshmërie kanë patur qeveritë në të tre mandatet e fundit.

Lidhur me sigurimin e nevojave të qeverisë për financimin me kosto të favorshme, huamarrja e brendshme do të vazhdojë të mbetet burimi kryesor i financimit dhe do të mbulojë në terma bruto mesatarisht mbi 75% të nevojave të përgjithshme për huatë e qeverisjes qëndrore. Instrumenti kryesor që do të përdoret për sigurimin e financimit janë titujt shtetëror kryesisht afatgjatë dhe me norma interesi fikse.

Huamarrja nëpërmjet burimeve të huaja do të plotësojë nevoja vjetore për hua në trema bruto të qeverisë qëndrore gati në 25% në varësi të nevojës për realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Sigurimi i financimit të nevojshëm në rast se huamarrja e brendshme tejkalon kufizimet e tregut. Pra, 20 miliardë lekë në terma neto.
- Sigurimi i financimit të nevojshëm në rastet kur huamarrja e brendshme tejkalon kufizimet e tregut (mbi 20 miliardë Lek në terma neto);
- Sigurimi i financimit të nevojshëm për të stabilizuar rastet e emergjencave të përkohshme në tregun e brendshëm;
- Ulja e presionit për hua në tregun e brendshëm për të mos kufizuar kreditimin e sektorit privat;
- Sigurimi i valutës së nevojshme për të mbuluar nivelin në rritje të shërbimit të borxhit në valutë;
- Shfrytëzimi i instrumenteve me terma të favorshme (jo tregtare) që ofrojnë institucionet financiare ndërkombëtare, me qëllim optimizimin e kostove të portofolit;
- Garantimi i pranisë së vendit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit mbi baza oportuniste.

Reduktimi i rreziqeve të borxhit (kryesisht të borxhit të brendshëm) me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të strukturës dhe reduktimin e kostove shtesë që burojnë nga primet e rrezikut në periudhën afatmesme dhe afatgjatë;

Në kuadër të reduktimit të rrezikut të rrefinancimit dhe atij të normave të interesit, do të synohet zgjatja e mëtejshme e jetëgjatësisë së borxhit të brendshëm nëpërmjet reduktimit të peshës së titujve afatshkurtër në portofol, si dhe duke mbajtur të qëndrueshëm peshën e titujve me norma interesi të ndryshueshëm. Ndërkohë, rreziku i kusit të këmbimit do të menaxhohet duke synuar mbajtjen e stokut të borxhit në monedhë të huaj brenda parametrave strategjik dhe atyre të qëndrueshëm, jo më shumë se 55% e totalit të borxhit.

Zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë do të synohet nëpërmjet realizimit të aktiviteteve, të cilat do të kenë si objektiv rritjen e likuiditetit, rritjen e efikasitetit, rritjen e transparencës. Realizimi i objektivave të mësipërme patjetër që është një synim afatgjatë, ndërkohë që zhvillimi i aktiviteteve dhe marrja e masave në këtë kuadër është një proces që do të kryhet në vazhdimësi.

Para se ta mbyll, dua të ndaj me ju ato që ju premtova, pra disa statistika ndër vite.

Deficiti i pritshmëm i vitit 2017 është -2%, në 2010 ka ardhur -3.1%,

në 2011 -3.5%, në 2013 -3.4%, në 2013 -5% me gjithë borxhet e prapambetura dhe do të vazhdojmë ta ulim. Vitin tjetër do të ngelemi në -2%, në 2019 kemi parashikim për ta reduktuar akoma më tej.

Ndërkohë, përsa i përket balancës primare, duke filluar që nga viti 2016 (edhe viti 2015 do të kishte dalë me balancë primare nëqoftëse nuk kishim pagesat e borxhit të akumuluar para 2013 që mezi e ndoqëm faturë më faturë), viti 2016 ishte +0.7%, në 2017 +0.4% dhe 2018 shkon +0.6%. 2011 ka qenë minus 0.4, në vazhdimësi minus 0.3, minus 1.7, e historia vazhdon. Megjithatë, jemi futur në një trajektore ulëse të borxhit publik, ku balanca primare është ancorë.

Balanca korente siç iu referova, është më e larta historike, mund ta them pa frikë, me +3.3%, këtë vit do dalë +3.1, pra pozitive në bazë të parashikimeve.

Për vitin 2006-2013, raporti lekë të Investuara me lekë të marra borxh është 1 me 1.18. Pra, për 100 lekë të marra borxh janë investuar 118, ndërsa në periudhën 2014-2017 për 100 lekë janë investuar 166 lekë. Raporti në buxhetin e 2018, është shumë më i lartë, është 3.96. Ndërkohë, ndryshimi i raportit, pra ndryshimi i raportit investime -borxh në buxhetin e 2018 krahasuar me periudhën 2006-2013, është ndryshimi 235%.

Ndërsa për të mos u krahasuar vetëm me 2006-2013, kemi sjell edhe ndryshimin e raportit investime borxh në buxhetin e 2018 krahasuar me periudhën tonë sërish 2014-2017, 138% ndryshimi.

Mund të vazhdoj me këto raporte të gjitha janë tejet pozitive. Pra, mund të vazhdoj me stokun e investimeve të akumuluar për 2014-2017, ndryshimi raportit është 254% pozitivisht me mandatin e PD-së. Po të vazhdojmë më tej të gjitha raportet tregojnë që manaxhimi i borxhit në mandatin e parë të Partisë Socialiste ka diferenca në numra dhe në cilësi me dy mandatet 2005-2013.

Këtu do ta mbyll prezantimin tim dhe jam gati në dizpozicion për t'u përgjigjur pyetjeve, apo për të diskutuar për opinione të ndryshme.